



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:218856

Datë: 12.10.2020

Numri i dokumentit: 01181246

C.nr.101/2019

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA KLINË-Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil, me gjyqtarin Fatmir Dobraj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit Prishtinë Rr..... Magj Prishtinë Fushë Kosovë ,pa nr. të cilin e përfaqëson Edona Marevci,e punësuar pran se nejtës kundër të paditurit F. G. K. nga fshati K.Klinë, baza juridike padi për Ribursim i demit, vlera e kontestit 3385 euro, jashtë seancë më datën 12.10.2020 bie këtë:

A K T G J Y K I M (P Ë R S H K A K T Ë M O S B I N D J E S)

APROVOHET SI E BAZUAR:kërkesëpadia e paditësit Rr.....Magjistrale Prishtinë Fush Kosovë pa nr.

Detyrohet:i padituri F. G. K. nga fshati Klinë,që paditësit të i'a ribursojë shumën prej 3385 euro ,në emer të ribursimit të demit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të dt.18.03.2016,në Klinë ,dhe atë më kamatëvonesën vjetorë prej 8% duke filluar nga dt.12.10.2020 e deri ne pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 euro,e të gjitha këto ne afatë prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ketij aktgjykimit,e nën kërcenim të përmbaramit.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij ka parashtruar padi me datën 08.03.2019,gjatë theksimeve të tijë e ka parashtruar çështjen si ne vijimë,se qendron pranë padisë dhe kërkesës së sajë,dhe njeta duke u bazuar ne provatë materiale të cilat i ka dorëzuar dhe arsyeshmerin ligjore të njetën ta aprovoi, në tersi po ashtu si rrethanë tjetër lidhur me këtë padi,ku në të cilën thuhet se I padituri ka shkatuar aksident trafiku ,dhe se automjeti në momentin e aksidentit ka qen pa mbules sigurues me afate të skaduar duke u bazuar në LMD dhe Ligjin per sigurimin të detyrueshme të autopërgjegjesisë për demet e shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike paditësja pala se tretë të demtuarit A. H. sh.p.k dhe A. dhe Sh. G. ,për shkakë të demit material dhe jo matërial ka paguar demin në shumë prej 3385 euro të cilat i ka pësuar nga ky aksident të demtuarve pasi qe i padituri ne ditën kritike ka drejtuar automjetin me nr targa,te pa siguruar,të regjistruar dhe fiton të drejtën paditësit për regresë te mjeteve nga paditësi të paguar palev të treta për demtim e shkaktuar si dhe shpenzimet i ka kërkuar.

Gjykata në kuptim të nenit 394,të Ligjit për Procedurën kontestimore nr.03/L-006 I publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me tutje LPK-së ka vepruar në këtë çështje kontestimore duke i derguar të paditurit njoftimin si në aktvendimin e

dt.02.09.2020.Për dhenjen e përgjigjejes në padi e se bashku me provat dhe i padituri nuk është përgjigjur në afatë prej 15 ditësh.

Duke berë shikimin në fletëdergesë për dorëzim personal konstaton se të njetën e ka pranuar se bashku me aktvendim e dt.02.09.2020 dhe provat material dhe e ka pranuar nënshkruar me dt.010.09.2020.Mirëpo edhe pse ka kaluar afati paraparë për dhenje të përgjigjes në padi i njeti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar ne dispozitat ligjore të nenit 150.1 të LPK-së, gjykata mori aktgjykim për shkak të mosbindjes, ndonëse jan plotësuar kushtet si me poshtë .

Gjykata ka konstatuar këtë gjendje si dhe duke u bazuar sipas provavë në shkresa të lëndës dhe atë a) të paditurit I është dorëzuar në menyre të rregulltë padia ,provat material dhe thirrja aktvendimi për dhenjen e përgjigjes në padi b)Themëlsia e kërkesë padisë rezulton nga faktet të treguara në padi dhe c)Faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi.

Dhe se me dt. 16.06.2016,për të dëmtuarin, dhe me dt.14.02.2017,për të dëmtuarit familja G.,dhe me dt.16.06.2016 për të dëmtuarin A. H.,është bërë pagesa nga pala paditëse paleve të demtuarë sipas flet transferit bankarë përmes bankës ekonomike sh.a.Kosovë.

Ku decidivisht parashihet ne nenin 150 pika 1të LPK-së,në qoftesë I padituri brenda afatit të përcaktuar me ligj,nuk paraqet në gjykatë përgjigjeje ne padi,gjykata jep aktgjykim me të cilën e aprovon kërkesë padinë,dhe ne parg 1pika b) po qese të themelësia e kerkesëpadisë del nga faktet e treguar në padi. Mëqenësë I padituri nuk e ka dhenë përgjigjen në padi, dhe në bazë të nenit 150 të LPK-së muar këtë aktgjykimi për shkakë të mosbindjes.

Andaj në kuptim të nenit 160.6 të LPK-së jan dhenë vetëm arsyet qe e justifikojnë marrjen e këtij aktgjykimit.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave te nenit 382 të LPK-së

Vendimin për shpenzimet e procedurës u moren sipas nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së me ç'rast pales paditëse I jan pranuar shpenzimet në emer të taksës gjyqësore në shumën e përgjitheshme prej 30 euro.

Andaj duke ju referuar të lartë cekurave u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË- DEGA NË KLINË Departamenti i Përgjithshëm
Civl C.nr.101/2019 datë 12.10.2020**

**Gjyqtari,
Fatmir Dobraj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15(pësemdhjet) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.